



Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus + në University of Trento, Itali

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentë dhe staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, në University of Trento, (Università di Trento), Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Shkëmbimin e stafit akademik dhe administrativ.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi (*Cikli i parë, i dytë, ose i tretë*) në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave.

Kohëzgjatja e bursave për studentët:

- 1 semestër, 5.5 muaj, Shkurt - Korrik 2022

Fushat e studimit:

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Numri total i studentëve për mobilitet - 5 studentë.

Numri total i stafit – 4 staf akademik, 2 staf administrativ.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit të studimeve (Bachelor, Master);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

*Ofrohen kurset e studimit, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2 për gjuhën angleze dhe rekomandohet A2 për gjuhën italiane. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës. Në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Trento lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj. Kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik dhe administrativ:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Certifikatë e gjuhës së huaj*;
- Vërtetim pune;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching/Training Mobility Agreement.

**Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2 për kurset në gjuhën angleze dhe B2 për kurset në gjuhën italiane. Stafi duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në University of Trento, hapni dokumentin [UniTrento Fact Sheet 2021-2022.pdf \(unitn.it\)](#) dhe te rubrika **Academic Programs and Course Catalogue**, klikoni **Choose your courses**.

Përparësi në politikat Universitetit të Unitrentos në mobilitetet e studentëve kanë kategoritë e disavantazuara.

Afati për aplikim për studentët, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: **Deri më 8 tetor 2021**

Afati i aplikimit online, pranë University of Trento, të studentëve të nominuar, është



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –



deri më 31 Tetor 2021, në linkun:

[Incoming mobility \(unitn.it\)](https://unitn.it)

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abego@upt.al